



## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **EKSTRAKT**

**nga procesverbali i mbajtur më 3 shkurt 2016, në mbledhjen XXI – të (njëzetënjë) të Komitetit për Komunitete.**

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 11.10’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Shaban Ahmeti, kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti Bahri Selimi, Shaban Osmani, Radisav Perović, Xhafer Ademi, Mefail Rama dhe Xhevdet Beselica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Bashkim Bajrami, Policia Kufitare, Bekim Karaxhija OSBE dhe Gabor Horvath KFOR, LMT.

#### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri.

#### **2. Shqyrtimi dhe miratimi i Ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 3 shkurt 2015 2016**

Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.

#### **3. Raporti i punës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2015**

**z. Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Xhafer Ademi**, theksoi, e përgëzoj z. Liman Zeqirin, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, për përgatitjen e këtij Raporti ngase është përmbajtësor dhe janë përfshirë çështjet esenciale dhe se paraqet gjendjen reale për punët dhe aktivitetet e kryera në vitin 2015.

**z. Mefail Rama**, theksoi, edhe unë e falënderoj z. Liman Zeqirin, për hartimin e këtij Raporti dhe pasqyrimin real të punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në vitin 2015.

Kur bëhet fjalë për numrin e të punësuarve, nxënësve dhe përfituesve të ndihmave të ndryshme të dhënat paraqiten për komunitetet RAE, shembull numri i të punësuarve është 22 por prej tyre unë nuk jam në dijeni se sa të punësuar janë të komunitetit rom, andaj sugjerimi im është që në të ardhmen të specifikohen në mënyrë të qartë të dhënat për komunitetet përkatëse.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, pajtohem me sugjerimin e parafolësit dhe shtoi, ky Raport është i punuar në bazë të të dhënave të Drejtorive përkatëse, edhe unë e kam vërejtur çështjen e ngritur nga parafolësi, mirëpo zyrtarët kompetent nuk kanë qenë në gjendje të definojnë në mënyrë konkrete se personat e caktuar ai përkasin komunitetit ashkali, egjiptas apo rom, andaj për këtë arsye janë përfshirë në kuadër të komuniteteve RAE.

Nëse z. Mefail Rama është i interesuar jo vetëm për të punësuarit por për të gjitha kategoritë mund t'i ofroj emrat dhe mbiemrat e personave përkatës dhe ai mund t'i identifikoj dhe të nxjerr të dhënat për të tri komunitetet e cekura.

#### **4. Plani i veprimit i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas në komunën e Podujevës për periudhën 2016 – 2020**

**z. Liman Zeqiri**, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, e paraqiti fjalën hyrëse.

Plani i veprimit u miratua njëzëri.

#### **5. Të ndryshme**

**Kryesuesi z. Shaban Ahmeti**, theksoi, i uroj mirëseardhje dhe punë të mbarë kontingjentit të ri të KFOR – it dhe shprehu bindjen se bashkëpunimi i ndërsjellë do të jetë në nivel ashtu siç ka qenë deri më tash.

**z. Gabor Horvath**, përfaqësues i KFOR – it, u falënderua për urimet e kryesuesit z. Shaban Ahmetit.

**Mbledhja përfundoi në orën 12.05'.**

**Procesverbalin e mbajti**

**Faik Gashi**

**Nr. 01-006-22657**

**Podujevë,**

**3 mars 2016**

**Kryesuesi i Komitetit**

**Shaban Ahmeti**